



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën c. nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 3, dhe 18 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt, të mbajtur më 29.05.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Lëshuarje në diskutim publik të Projekt-Rregulloreve komunale: Për subvencione dhe transfere dhe Projekt-Rregulloren për simbole, ndarjen e titujve të nderit, dekoratave, pllaketave, medaljeve, mirënjohjeve, falënderimeve dhe shpërblimeve të tjera.

I

Lëshohen në diskutim publik,

-Projekt-Rregullorja për subvencione dhe transfero dhe
-Projekt-Rregullores për simbolet, ndarjen e titujve të nderit, dekoratave,
pllaketave, medaljeve, mirënjohjeve, falënderimeve dhe shpërblimeve tjera

II

Ndryshimet dhe plotësimet si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohen në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe web faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe organizatat e biznesit, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin tekstin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullorës në Zyrën ligjore në objektin e Komunës, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të jepën pranë kësaj zyre.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio-"ALBA".

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 07-3667/2015
Klinë, më 01.06/2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi